



RAPORTI VJETOR 2023

Profili i Kompanisë

EUROSIG, si shoqëri e konsoliduar në tregun e sigurimeve, është e shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me dhjetëra degë e agjenci dhe rreth 200 pika shitjeje e përfaqësimi. Aktualisht, në Eurosig janë të punësuar qindra punonjës në nivel qendror dhe vendor.

Përkushtimi në shërbimet e sigurimit që ofrojmë ka sjellë rritjen e vazhdueshme të numrit të klientëve, të cilët na kanë besuar. Nga viti në vit, nën siglën "EUROSIG", treguesit ekonomiko-financiare të shoqërisë kanë shënuar rritje 2-shifrore.



*Përkushtimi në
shërbimet e sigurimit
që ofrojmë ka sjellë
rritjen e numrit të
klientëve, të cilët na
kanë besuar*

Përmbajtja

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës	4
Fjala përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm	6
Struktura qeverisëse e shoqërisë	8
Vizioni, misioni, vlerat e Eurosig	9
Burimet njerëzore, veprimtaritë kryesore, klientët dhe partnerët e Eurosig	11
Eurosig nëpërmjet shifrave	16
Disa të dhëna për Grupin Financiar Eurosig–Insig–UBA	18
Përgjegjësia sociale dhe promovimi i vlerave	21
Pjesëmarrjet e Eurosig në kapitalin e shoqërive të tjera	36
Lista e aksionarëve të Eurosig me pjesëmarrje influencuese të kapitalit	36
Lista e administratorëve të Eurosig	36
Opinion i shkurtuar mbi auditimin e brendshëm	37
Monitorimi, administrimi dhe kontrolli i riskut që ndërmerr Eurosig	41
Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, të likuiditetit dhe të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike	46
Objektivat për vitin 2023	48

Mesazhi

i Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës



Vasil PILO

Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

**Grupi Financiar
Eurosig-INSIG-UBA
po performon
me sukses në
Republikën e
Shqipërisë dhe
Republikën e
Kosovës**

Të nderuar lexues dhe aksionarë të Eurosigs,

Me gjithë ndikimin në rritje të zhvillimeve gjeopolitike në mjedisin ekonomik dhe financiar, viti 2023 ishte i suksesshëm në realizimin e objektivave dhe prioriteteve tona. Në sajë të planifikimeve të kujdesshme dhe drejtimit strategjik afatmesëm dhe afatgjatë, Grupi Financiar Eurosig-INSIG-UBA po performon me sukses në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës, duke treguar qëndrueshmëri dhe standarde të larta.

Rezultatet e arritura janë shprehja më e mirë e leadershipit vizionar, drejtimit me integritet, vendimmarrjes së suksesshme dhe performancës në rritje të menaxherëve dhe stafeve respektive të subjekteve të Grupit. Punonjësit tanë besojnë në atë që bëjnë dhe punojnë gjithnjë e më shumë.

Bashkëpunimi i suksesshëm që kemi përforcuar në vite me klientët dhe partnerët tanë është në themel të standardeve të larta të arritura. Në udhëtimin tonë të përbashkët dhe vizionar, kemi identifikuar vazhdimisht mundësi të reja, duke ecur me kërkesat e tregut dhe përshtatur me nevojat e klientëve.

Në 19 vite veprimtari, Eurosigs ka vepruar si biznes i motivuar shpirtërisht, duke ndihmuar njerëzit të ndërtojnë një të ardhme më të sigurtë, duke u kujdesur për jetën dhe pasuritë e tyre, duke ofruar zgjidhje me kompetencë dhe qasje njerëzore.

Rritja dy shifrore në tre vitet e fundit, performanca, konsolidimi dhe stabiliteti brenda normave të lejuara i treguesve ekonomik-financiarë tregojnë se Eurosigs është e shëndetshme dhe se sistemet e saj të kontrollit dhe ato operacionale janë në gjendje të përballojnë volumin e një rritjeje konstante të biznesit. Ndër vite, Eurosigs e mbështet rritjen e vet fitimprurëse mbi baza të shëndetshme financiare, duke rritur vlerën për aksionerët tanë, si dhe duke krijuar mundësi për karrierë dhe shpërblime financiare për punonjësit dhe agjentët, që përfaqësojnë çdo ditë Eurosigsun në mbarë vendin. Kjo shërben si garanci në realizimin me sukses të objektivave strategjike dhe prioriteteve tona.

Në emër të Këshillit Mbikëqyrës, dëshiroj të falënderoj Menaxhimin e Lartë, Menaxhimin Operacional dhe të gjithë punonjësit e shoqërisë Eurosigs për punën dhe arritjet në vite. Përkushtimi dhe angazhimi juaj vijues ndaj klientëve është garanci suksesi në të ardhmen.

Falënderim i veçantë për arritjet tona u takojnë aksionerëve, për mbështetjen e vazhdueshme; klientëve dhe partnerëve të biznesit, për besimin që na kanë dhënë ndër vite.

Duke u mbështetur në rezultatet e arritura, në aftësitë dhe pasionin e qindra kolegëve dhe agjentëve tanë dhe në mbështetjen e vazhdueshme të aksionerëve, ne jemi gati të shkruajmë së bashku faqe të tjera të rëndësishme në historinë gati njëzetëvjeçare të Eurosigs, duke vazhduar krijimin e vlerave të qëndrueshme për të gjitha palët e interesuara dhe për të qenë një partner i besueshëm për secilin prej klientëve tanë.

Mesazhi

i Drejtorit të Përgjithshëm



Eurosig ka treguar përkushtim, siguri të standardeve të larta, shërbim cilësor në rritje, dëmshpërblim të drejtë dhe në kohë.

Xhevdet KOPANI
Drejtori i Përgjithshëm

Të nderuar klientë, partnerë, miq e bashkëpunëtorë,

Të nderuar punonjës të Grupit Eurosig-Insig-UBA,

Publikimi i progres raportit për vitin 2023 për shoqërinë Eurosig sh.a. realizohet në një moment të shënuar të rrugëtimit të saj, në 20 - vjetorin e krijimit të kësaj shoqërie.

Eurosig, në këto 20 vite, u rrit, u konsolidua, përmirësoi qeverisjen dhe, mbi të gjitha, fitoi mbështetjen dhe besimin e klientëve. Janë qindra mijëra klientë që çdo vit i besojnë Eurosigut pasurinë, asetet, shëndetin, përgjegjësinë etj.

Eurosig ka treguar përkushtim, siguri të standardeve të larta, shërbim cilësor në rritje, dëmshpërblim të drejtë dhe në kohë.

Histori suksesi është bashkëpunimi me partnerët tanë, risiguruesit, brokerat ndër më të rankuarit në Europë, gjithashtu me organizatat e biznesit të të gjitha natyrave brenda e jashtë Shqipërisë.

Pjesë e këtij rrugëtimi është edhe viti 2023. Spikat në këtë vit rritja dyshifrore dhe qëndrueshmëria në treg e shoqërisë Eurosig.

Digjitalizimi i shërbimeve të afuara, ofrimi online jo vetëm i marrjes së policës, por dhe aplikimi për dëmshpërblim, duke e mbyllur plotësisht ciklin e sigurimeve, janë jo vetëm një mundësi më e madhe për klientët, por dhe një tregues i rëndësishëm i progresit të shoqërisë.

Zbatimi i standardeve dhe kërkesave të Mbikëqyrësit, bashkëpunimi me auditorët dhe aktuarët kanë qenë dhe mbeten drejtim i rëndësishëm i qeverisjes korporative.

Dimensioni social i shoqërisë Eurosig, e mbështetur fort nga filozofia e Aksionarit të shoqërisë, Z. Kadri Morinaj, përbën ndër avantazhet tona jo vetëm në industrinë financiare, por në tërë biznesin vendas.

Eurosig ka këto rezultate dhe do të vazhdoj të performojë gjithnjë në rritje, falë mbështetjes nga Aksionari Z. Kadri Morinaj, nga Këshilli Mbikëqyrës dhe, mbi të gjitha, nga puna dhe përkushtimi i kolegëve të mi dhe i të gjithë punonjësve në të gjithë Shqipërinë, për të cilët kam falënderimet më të sinqerta.

Sfidat për vitin 2024 janë të mëdha. Rritje dyshifrore e shitjeve, arritja e raportit dëme/prime me mbi 30%, reduktimi i kohës së trajtimit të dëmeve me mbi 10%, konsolidimi i shërbimeve online dhe ideimi e hedhja në treg e dy produkteve të reja në fushën e sigurimeve, në tre mujorin e katërt të 2024-ës, përbëjnë jo vetëm sfida, por dhe detyra që duhen përmbushur.

Struktura qeverisëse e shoqërisë

Në Eurosig kemi implementuar praktikat më të mira të qeverisjes korporative, duke ndarë të drejtat dhe përgjegjësitë ndërmjet Asamblesë së Aksionarëve, Këshillit Mbikëqyrës, Drejtorit të Përgjithshëm, Menaxhimit të Lartë, Menaxhimit Operacional dhe Funkcioneve Kryesore të Kontrollit. Në funksion të mirëqeverisjes, janë krijuar dhe funksionojnë edhe Komiteti i Auditimit&Menaxhimit të Riskut, Komiteti për Sigurinë Kibernetike dhe Vazhdimësinë e Biznesit, Komiteti i Investimeve, Komiteti i Risigurimit dhe Komiteti i Vlerësimit të Dëmeve.

Fushat e përgjegjësisë të organeve mbikëqyrëse, ekzekutive dhe menaxheriale, të komiteteve dhe funksioneve kyçe të kontrollit janë të përcaktuara në aktet e brendshme të Eurosig. Kjo ndikon pozitivisht në mënyrën e përcaktimit të strategjive dhe objektivave të Eurosig, përzgjedhjen dhe mbikëqyrjen e personelit, kryerjen e veprimtarive ditore, respektimin e Kodit të Sjelljes dhe Etikës, duke operuar në pajtueshmëri me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Përgjegjësitë e organeve mbikëqyrëse, ekzekutive dhe menaxheriale, të komiteteve dhe funksioneve kyçe të kontrollit janë të përcaktuara në aktet e brendshme të Eurosig



Vizioni, misioni, vlerat e Eurosig

Vizioni

Të qenit lider në fushën e sigurimeve, bazuar në standarde europiane, që orientohet nga performanca e shtuar, në përputhje me kërkesat e palëve të interesuara, duke u mbështetur në filozofinë e vlerave, profesionalizmit, bazueshmërisë ligjore, reflektimit ndaj kërkesave të klientit dhe fokusimit tek ai.



Misioni

Misioni i Eurosig është:

- të sigurojë produkte, shërbime dhe aktivitete ndaj klientëve, nëpërmjet përsosjes së shërbimit, cilësisë, profesionalizmit, etikës, duke funksionuar si një shoqëri financiare, me qëllim optimizimin e kërkesave të klientëve, rritjen e kapitalit financiar, rritjen e vlerës së aksioneve, duke i siguruar klientët për mbështetje në çdo kohë, për kompensim të plotë dhe të drejtë për dëmet e mundshme;
- të ofrojë shërbime sipas standardeve europiane, duke konsoliduar pozicionin e saj dhe duke garantuar emër e reputacion tek partnerët rajonalë, europianë e më gjerë;
- të marrë reagime (feedback) nga klientët me forma e metoda bashkëkohore dhe reflektim të tyre, për të përmirësuar shërbimin.

Vlerat e Eurosig

Shoqëria Eurosig përbën një vlerë të shtuar në industrinë e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon. Përvoja 19 vjeçare në fushën e sigurimeve, zgjerimi i veprimtarive edhe në fusha të tjera financiare, i ka konsoliduar këto vlera, duke i bërë të qëndrueshme dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimet e shoqërisë dhe të Grupit.

Filozofia e Eurosigut për orientimin ndaj klientit, përbën një qasje që mbart vlera për tani dhe të ardhmen. Ne kemi krijuar marrëdhënie afatgjata besimi me punonjësit, klientët, grupet e interesit duke iu përgjigjur kërkesave të tyre në kohë dhe me profesionalizëm. Në Eurosig punohet në grup, nxitet diversiteti, vlerësohen përpjekjet dhe puna orientohet drejt rezultatit.

Kontribut i çmuar i Eurosigut ndër vite është edhe përfshirja sociale, falë rolit të spikatur dhe vlerave altruiste të Presidentit të Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA, z. Kadri Morinaj.

Performimi i Eurosig në raport me industrinë e sigurimeve dhe historinë e saj në treg, rritja, zgjerimi dhe konsolidimi në tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, zgjerimi i veprimtarisë financiare të Grupit edhe në tregun bankar, të mikrokredive, të investimeve dhe pensioneve private përbëjnë një vlerë me ndikim pozitiv në performancën tonë në të ardhmen.



Burimet njerëzore, veprimtaritë kryesore, klientët dhe partnerët e Eurosig

Burimet njerëzore

Eurosig, si shoqëri e konsoliduar në tregun e sigurimeve, ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me 20 degë, 11 agjenci dhe 212 punonjës në nivel qendror dhe vendor. Duke i konsideruar burimet njerëzore si një faktor të rëndësishëm dhe kapitalin intelektual për rritjen e biznesit tonë, ne investojmë sistematikisht në përzgjedhjen, trajnimin, vlerësimin, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e punonjësve. Shtrirja e Eurosigut në të gjithë vendin, burimet njerëzore profesionale dhe me integritet, aftësitë e larta të organeve qeverisëse përbëjnë garanci për sukses dhe përballim të sfidave në të ardhmen.



Veprimtaritë kryesore të Eurosig

Shoqëria Eurosig ruan sandardet më të mira të produkteve të sigurimit, në përputhje me kërkesat e klientëve. Produktet tona janë hartuar duke u bazuar në produktet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit. Po kështu, Eurosig gëzon të gjithë ekspertizën e nevojshme dhe ofron asistencë dhe praktikën më të mirë të trajtimit të dëmeve.

Eurosig ushtron veprimtari sigurimi në përputhje me klasat, për të cilat është licencuar nga AMF. Linjat kryesore të biznesit të Eurosig përfshijnë veprimtaritë për sigurimin dhe risigurimin, për trajtimin e dëmeve, për çështjet ekonomiko-financiare, për çështjet ligjore, për teknologjinë e informacionit dhe sigurinë kibernetike, për kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e risikut etj.

Veprimtari kryesore e Eurosig është realizimi i procesit të shitjes dhe marrjes në sigurim:

- për produktet e sigurimeve vullnetare: Sigurimi i Aksidenteve Personale, Sigurimi i Shëndetit dhe Sëmundjeve, Sigurimi Kasko, Sigurimi i Pasurisë (nga zjarri dhe forcat e natyrës), Sigurimet ndaj Dëmtimeve dhe Humbjeve të Tjera të Pasurisë, Sigurimi i Garancive të Ofertave dhe të Kontratave, Sigurimi i Mallrave në Transport, Sigurimi i Përgjegjësive të Anijeve dhe Mjeteve Lundruese, Sigurimi i Përgjegjësive (profesionale/publike/të punëdhënësit), Sigurimi i Bankave BBB&ECC etj.;
- për produktet e sigurimit të detyrueshëm: Sigurimi i Detyrueshëm Motorik për Përgjegjësitë ndaj Palëve të Treta (DMTPL), Certifikata Motorike Ndërkombëtare e Sigurimit (Kartoni Jeshil), Sigurimet Kufitare etj.

Veprimtaritë e linjave të biznesit mbështeten nga një sistem dhe rrjet informatik bashkëkohor.



Klientët e Eurosig


Filozofia e Eurosig është e orientuar ndaj klientëve, duke synuar krijimin e një partneriteti afatgjatë me klientët tanë. Si rezultat i besimit të krijuar ndër vite, sot ne numërojmë mes klientëve tanë shoqëri dhe institucione të rëndësishme për vendin, si banka dhe institucione financiare, si dhe kompani të mëdha biznesi, për të cilat shërbimi është ofruar i personalizuar dhe në kohë reale. Synimi jonë është të ofrojmë zgjidhje praktike dhe të shpejta për kërkesat e klientëve tanë, si dhe përgjigje në kohë dhe në masë e dëmshpërblimeve, në rast dëmi. Për këtë qëllim, stafi i mirëtrajnuar dhe me aftësi të shkëlqyera teknike dhe komunikimi përcjell të njëjtën filozofi biznesi tek klientët.

Partnerët e Eurosig

Detyrimet financiare ndaj klientëve garantohen jo vetëm nga kapacitetet tona teknike dhe financiare, por dhe nga tregu financiar ndërkombëtar. Pjesëmarrësit në kontratat e risigurimit që lidh Eurosig janë shoqëri risigurimi që përbushin standardet ndërkombëtare të pagesës së dëmeve dhe stabilitetit financiar, të listuara në bazën e vlerësimeve ndërkombëtare, në përputhshmëri dhe në zbatim të kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të Eurosig.

Eurosig ka investuar një kosto të rëndësishme për risigurimet me kompani risigurimi prestigjioze, si Hannover Re, Polish Re, Generali Group, Scor, VIG Re etj. për të garantuar financiarisht detyrimet e mundshme dhe përgjegjësitë ndaj klientëve, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit. Në tetor 2023, Eurosig dhe Generali festuan 10-vjetorin e bashkëpunimit. Në takimin e përfaqësuesve më të lartë të kompanive, në zyrat e Generali Group në Milano, u shkëmbyen eksperiencat më të mira dhe u shprehën vlerësime për bashkëpunimin e gjatë dhe të frytshëm.

Grupi Eurosig ka ruajtur prej disa vitesh dhe ka zgjeruar bashkëpunimin edhe me risigurues të tjerë, si Munich Re, Sava Re dhe Swiss Re. Ne, gjithashtu zhvillojmë marrëdhënie bashkëpunimi për risqet fakultative edhe me kompani të tjera risiguruese, gjithnjë duke u mbështetur në kriterin e vlerësimit financiar dhe standardin e bashkëpunimit. Marrëveshjet e Risigurimit të Pronës dhe Përgjegjësive, si dhe Sigurimit të Detyrueshëm për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta (TPL, Sigurimi Kufitar dhe Karton Jeshil), përveç garancisë financiare në pagesat e dëmeve të mëdha, kanë krijuar një fleksibilitet dhe cilësi të veçantë shërbimi ndaj klientëve. Eurosig bashkëpunon me MARSH & Guy Carpenter, AON, AJ Gallagher etj., vlerësuar në top 5 brokerat më të fuqishëm në tregun ndërkombëtar të risigurimeve.



Vlerësime për partnerët e EUROSIG

HANNOVER RE

Bazuar në fuqinë financiare dhe vlerësimet e agjencive të vlerësimit, Hannover Re renditet si risiguruesi i tretë më i fuqishëm në botë. E themeluar më 1966 dhe me një staf prej më shumë se 3 000 punonjës, kjo kompani kryen aktivitet në të gjitha linjat e Risigurimit të Jo-Jetës, Jetës dhe Shëndetit, nëpërmjet më shumë se 170 degëve/agjencive/zyrave të përfaqësimit duke qenë e pranishme në të gjitha kontinentet.

Vlerësimi:

Rating Agency	Rating	Outlook
A.M. Best	A+	Superior
S&P	AA-	Very strong

POLISH RE

Shoqëria e Risigurimit Polish Re ka hyrë në tregun e Risigurimit që nga shtatori 1996. Ajo operon në 40 vende të botës, me mbi 200 klientë. Polish Re është një risigurues lider dhe ka fituar besimin e klientëve në të gjitha shtetet e Europës Qendrore dhe Lindore.

Vlerësimi:

Rating Agency	Rating	Outlook
A.M. Best	A-	Stable

Generali Group

Grupi Generali është një nga aktorët më të rëndësishëm në tregun e sigurimit global dhe financiar. Themeluar në vitin 1831, në Trieste, tani është i pranishëm në më shumë se 50 vende të botës nëpërmjet 500 kompanive ndërkombëtare. Me afro 72 000 punonjës që u shërbejnë 61 milion klientëve, Generali Group klasifikohet në listën e 20 risigurueseve më të mëdhenj në botë.

Vlerësimi:

Rating Agency	Rating	Outlook
A.M. Best	A	Stable
Fitch	A-	Stable

Eurosig bashkëpunon edhe me shoqëri të tjera risigurimi, vlerësuar si të sigurt dhe stabël në tregun ndërkombëtar, si AXA XL vlerësuar me AA- nga S&P, SCOR vlerësuar me A- nga AM Best, VIG Re vlerësuar me A+ nga S&P, Sava Re vlerësuar me A- nga S&P dhe AM Best.

A photograph of a business meeting in a modern office. Several people in business attire are gathered around a desk. A large computer monitor in the center displays various data visualizations, including bar charts, pie charts, and a world map. One person is pointing at the screen with a pen. The desk is cluttered with papers, a calculator, and a keyboard. The overall atmosphere is professional and data-driven.

Eurosig nëpërmjet shifrave

Viti 2023 ishte i suksesshëm në realizimin e objektivave strategjike dhe prioriteteve tona. Disa nga treguesit kryesorë të vitit 2023, krahasuar me vitin 2022, janë:

- Volumi i primeve të shkruara bruto është 2,875,560,000 lekë, duke u rritur me 10.34%.
- Volumi i dëmeve të paguara është 800,297,000 lekë, me një rritje prej 15.18%.
- Volumi i sigurimeve vullnetare kundrejt totalit është 19.97%, 2.05 pikë përqindje më shumë.
- Për treguesin e volumit të primeve të shkruara bruto:
 - në Sigurimin Motorik kemi rritje me 8.29%, zotërojmë 15.57% të tregut, renditemi në vendin e tretë;
 - në produktet MTPL e Brendshme kemi rritje me 9.61%, zotërojmë 15.25% të tregut, renditemi në vendin e dytë;
 - në Sigurimin Kartoni Jeshil kemi rritje me 1.39%, zotërojmë 24.74% të tregut, renditemi në vendin e dytë;
 - në Sigurimin Kufitare zotërojmë 24.80% të tregut, renditemi në vendin e tretë;

- në Sigurimin Kasko zotërojmë 7.22% të tregut, renditemi në vendin e pestë;
- në Sigurimin Zjarri, Forcat e Natyrës&Dëmtimet e Tjera në Pronë kemi rritje me 63.86%;
- në Sigurimin Shëndeti në Udhëtim kemi rritje me 3.03%, renditemi në vendin e tretë;
- në Sigurimin e Përgjegjësive Civile kemi rritje me 78.45%, renditemi në vendin e tretë;
- në Sigurimin e Përgjegjësive në Ndërtim kemi rritje me 53.29%, renditemi në vendin e tretë.
- Volumi i dëmeve të paguara:
 - në Sigurimin Motorik është 633,118,000 lekë, me një rritje prej 4.72%;
 - në Sigurimin MTPL e Brendshme është 439,060,000 lekë, me një rënie prej 10.94%;
 - në Sigurimin Kartoni Jeshil është 108,746,000 lekë, me një rritje prej 63.98%;
 - në Sigurimin Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtimet e Tjera në Pronë është 103,424,000 lekë, duke u rritur me 313.07%;
 - nga Fondi i Kompensimit është 53,429,000 lekë, me rritje prej 89.80%.

Disa të dhëna për Grupin Financiar Eurosig-Insig-UBA

Organizimi dhe funksionimi i Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA

Sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe rregullatore, Grupi Financiar Eurosig-Insig-UBA funksionon i përbërë nga: shoqëria Eurosig sh.a, shoqëri mëmë; shoqëritë Insig sh.a, Insig Jetë sh.a, Eurosig sh.a Kosovë, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Eurosig-Invest sh.a. dhe Eurosig-MicroCredit sh.p.k, si shoqëri të kontrolluara.

Shoqëritë e Grupit gëzojnë parametrat e gjendjes financiare për vitin 2023 në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.



Lloji i veprimtarisë së subjekteve të Grupit dhe totali i aktiveve më 31 dhjetor 2023

- ◆ Eurosig sh.a. Shqipëri, e licencuar për veprimtarinë e sigurimit Jo-Jetë: Aktivet totale 11,474,864,216 Lekë.
- ◆ Insig sh.a. Shqipëri, e licencuar për veprimtarinë e sigurimit Jo-Jetë: Aktivet totale 4,783,360,931 Lekë.
- ◆ Insig Jetë sh.a. Shqipëri, e licencuar për veprimtarinë e sigurimit Jetë: Aktivet totale 1,363,842,320 Lekë.
- ◆ Eurosig sh.a. Kosovë, e licencuar për veprimtarinë e sigurimit Jo-Jetë: Aktivet totale 27,613,143 Euro.
- ◆ Banka e Bashkuar e Shqipërisë, e licencuar për veprimtarinë bankare: Aktivet totale 12,695,874,453 Lekë.
- ◆ Eurosig-MicroCredit sh.p.k. Shqipëri, e licencuar për veprimtarinë e faktoring dhe kredidhënies: Aktivet totale 314,114,299 Lekë.
- ◆ Eurosig-Invest sh.a. Shqipëri, në proces licencimi: Aktivet totale 24,585,660 Lekë.
- ◆ Aktivet totale të Grupit Financiar Eurosig-INSIG-UBA, më 31 dhjetor 2023, rezultuan 27,267,810,533 Lekë.

Treguesit kryesorë të shoqërive të sigurimit të Grupit për vitin 2023 (në Lekë)

EMËRTIMI	VOLUMI I PRIMEVE TË SHKRUARA BRUTO	PESHA SPECIFIKE NDAJ TOTALIT	DËME TË PAGUARA BRUTO
EUROSIG SHQIPËRI	2,875,560,000	43.68%	800,297,000
EUROSIG KOSOVË	1,859,231,000	28.24%	942,273,958
INSIG JO-JETË SHQIPËRI	1,443,515,000	21.93%	341,939,000
INSIG JETË SHQIPËRI	403,857,000	6.15%	68,781,000
TOTALI	6,582,163,000	100%	2,153,290,000

- ✦ Krahasuar me vitin 2022, kemi rritje: Insig-Al Jetë sh.a. me 35.54%, Eurosig-KS sh.a. me 15.39%, Eurosig-Al sh.a. me 10.34% dhe Insig-Al sh.a. me 5.70%.
- ✦ Në Republikën e Shqipërisë:
 - o Eurosig dhe Insig së bashku zotërojnë 20.55% të tregut të Sigurimit të Jo-Jetës, duke u renditur në vendin e dytë, dhe 24.1% të tregut në Sigurimin Motorik, duke u renditur në vendin e parë;
 - o Insig Jetë zotëron 21.72% të tregut të Sigurimit të Jetës, duke u renditur në vendin e dytë.
- ✦ Në Republikën e Kosovës, Eurosig-KS zotëron 12,23% të tregut të jo-jetës, duke u renditur në vendin e dytë, dhe 11.86% të tregut në MTPL e Brendshme, duke u renditur në vendin e parë.

Përgjegjësia sociale dhe promovimi i vlerave

Përgjegjësia sociale është një vlerë e shtuar e Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA. Falë angazhimit dhe kujdesit të vazhdueshëm të Presidentit, Z. Kadri Morinaj, subjektet e Grupit janë të angazhuara për të maksimizuar ndikimin pozitiv në shoqëri dhe në mjedis. Një vëmendje të veçantë Grupi Eurosig-INSIG-UBA dhe Presidenti Morinaj kanë ndaj mjedisit kulturor, artistik, mediatik, ndaj shtresave në nevojë etj.



Veprimtaritë kryesore në kuadër të përgjegjësisë sociale dhe promovimit të vlerave të Grupit Financiar Eurosig-INSIG-UBA:

- ♦ **Janar 2023** - Grupi Eurosig-Insig-UBA nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Epoka, me qëllim rritjen e bashkëpunimit për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve dhe shkëmbimin e eksperiencave të përbashkëta. Ky bashkëpunim synon mbështetjen e zhvillimeve të qëndrueshme të ekonomisë, promovimin e punimeve shkencore për shërbimet financiare, sjelljen e ideve inovatore në shërbim të politikave të zhvillimit për një vendimmarrje të mbështetur në punime kërkimore dhe shkencore etj.
- ♦ **Shkurt 2023** - Grupi Eurosig-Insig-UBA akordoi 30 000 Euro në ndihmë të familjeve të dëmtuara nga tërmetet në Turqi. Presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, shprehu keqardhje maksimale për situatën e krijuar dhe uroj rikuperim të shpejtë të familjeve të dëmtuara.
- ♦ **Mars 2023** - Mbështetje për trajnimin e studentëve të Universitetit Epoka me njohuri për industrinë e sigurimeve (24 janar-18 shkurt 2023). Në ceremoninë përmbyllëse të trajnimit morën pjesë Presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, Rektori i Universitetit Epoka, Prof. Dr. Ahmet Ostaz, Menaxhmenti i Grupit, si dhe pedagogë e studentë të Universitetit Epoka. Trajnimi i ofruar nga menaxherë të lartë të Eurosig ishte një mundësi e shkëlqyer për studentët, për të patur një qasje teorike mbi sigurimet dhe mundësitë që ofron tregu i



Grupi Eurosig-Insig-UBA Bank nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Epoka, me qëllim rritjen e bashkëpunimit



punës i industrisë së sigurimeve. Grupi Eurosig dha 5 çmime për studentët më të mirë në trajnim dhe akordoi bursa të plota Masteri për disa studentë ekselentë. Presidenti i Grupit, Z. Morinaj, mbajti një fjalim inkurajues për studentët, duke evidentuar momentet kryesore në rrugëtimin e tij në fushën e biznesit. Ai theksoi se “dyert e Grupit Eurosig janë të hapura për çdo student që ka dëshirë të punojë dhe të rritet profesionalisht”.

- ♦ **Mars 2023** - Mbështetje për Konferencën Ndërkombëtare “Sfidat në Ballkanin Perëndimor: Infrastruktura dhe Zhvillimi në Rajon”, të organizuar nga Universiteti EPOKA, së bashku me Këshillin Global të Dekanëve të Inxhinierisë (GEDC) dhe Federatën Ndërkombëtare të Shoqërive të Edukimit Inxhinierik (IFEES). Akademikë, drejtues të industrive, studiues, profesorë, doktorë, organe qeveritare dhe organizata joqeveritare morën pjesë në këtë konferencë ndërkombëtare inovative. Në një panel drejtuesish kompanish ndërkombëtare, ishte i ftuar edhe Presidenti i Grupit Eurosig-Insig-UBA, Z. Kadri Morinaj, i cili shpjegoi sfidat dhe nevojën e zhvillimit të tregut, veçanërisht të industrisë së sigurimeve. Z. Morinaj shprehu shqetësimin e tij edhe për largimin e trurit dhe fuqisë punëtore nga Shqipëria.


- ✦ **Mars 2023** – Grupi Eurosig-Insig-UBA shtroi një darkë madhështore te Bar Restorant “Piazza” për pjesëmarrësit nga shumë vende të botës në Konferencën Ndërkombëtare “Sfidat në Ballkanin Perëndimor: Infrastruktura dhe Zhvillimi në Rajon”. Gjatë mbrëmjes, Presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, u vlerësua me një çmim të veçantë nga Dr.Ahmet Oztas (Rektor i Universitetit Epoka), Dr.Sunil Maharaj (President i GEDC) dhe Dr.Hans Hoyer (Drejtor Ekzekutiv i IFEEES dhe GEDC) për kontributin, bujarinë dhe vlerat kombëtare të treguara gjatë dy ditëve të konferencës. Gjithashtu, z. Morinaj u vlerësua për mikpritjen nga Dr.Michael Milligan, President i ABET Engineering Accreditor – SHBA, nga Paul Gilbert, CEO of Quanser – Kanada etj.
- ✦ **Prill 2023** – Pjesëmarrje në Panairin e Punës 2023, në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, me qëllim nxitjen e gatishmërisë dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve të këtij fakulteti. Interesi dhe dëshira e studentëve për të qenë pjesë e Grupit Eurosig-Insig-UBA ishte shumë e lartë. Mbi 220 studentë aplikuan për t’u bërë pjesë e familjes tonë, si kandidatë potencialë për punësim apo praktikë mësimore.
- ✦ **Prill 2023** – Shumë punonjës të Grupit Eurosig-Insig-UBA morën pjesë në trajnimin I LOVE MY BUSINESS, një Event dy ditor LIVE nga Ermal Mamaqi dedikuar rritjes dhe zhvillimit në karrierë, biznes dhe jetë. I ftuar në këtë event, Presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, foli për rrugëtimin e Tij të

suksesshëm në biznes dhe u bëri thirrje të rinjve të mos emigrojnë, por të japin kontributin e tyre për t’u rritur profesionalisht dhe për ta bërë Shqipërinë një vend më të mirë për brezat që do vijnë.

- ✦ **Maj 2023** – Mbështetje e Festivalit Folklorik “Hasi Jehon” në organizimin e Edicionit të 34-ët, i cili u mbajt në fshatin Gjonaj, në Kosovë. Presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, përshëndeti këtë festival dhe konfirmoi mbështetjen edhe për vitet e ardhshme.
- ✦ **Maj 2023** – Grupi Eurosig-Insig-UBA mundësoi organizimin e 5-vjetorit të krijimit të Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë. Në këtë event mori pjesë edhe Delegacioni i Këshillit të Ambasadorëve Amerikanë. Presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, u nderua nga Këshilli i Ambasadorëve Amerikanë me Medaljen “Benjamin Franklin – Ambasadori i Parë Amerikan”, për mikpritjen e veçantë dhe të ngrohtë në Shqipëri. Zoti Morinaj i siguroi Ambasadorët nga SHBA që Dyert e Tij do të jenë gjithmonë të hapura për ta.
- ✦ **Maj 2023** – Pjesëmarrje në Panairin e Karrierës, me qëllim nxitjen e gatishmërisë dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve të Universitetit Epoka, një ndër universitetet më prestigjioze në vend. Studentëve iu ofrua mundësia për të qenë pjesë e stafeve të kompanive të Grupit Eurosig-Insig-UBA. Të shumtë ishin ata që aplikuan për t’u bërë pjesë e familjes tonë, si kandidatë potencialë për punësim apo praktikë mësimore.



- ✦ **Maj 2023** – Pjesëmarrje në Panairin e Punës, në Universitetin European të Tiranës, me qëllim nxitjen e gatishmërisë dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve të këtij universiteti të njohur. Studentëve që treguan interes dhe dëshirë iu ofrua mundësia për të qenë pjesë e Grupit Eurosig-Insig-UBA. Shumë prej tyre aplikuan për t'u bërë pjesë e familjes tonë.
- ✦ **Qershor 2023** – Më 1 qershor, Ditën e Fëmijëve, Grupi Eurosig-Insig-UBA bëri të lumtur mbi 300 fëmijë në qytetin e Librazhdit. Me iniciativën e Klark Morinaj, në këtë qytet u organizua një festë e madhe për të gjithë fëmijët, me lojëra, animatorë dhe mjaft aktivitete të tjera. Ata do ta kujtojnë gjatë atmosferën festive që u krijua. Për fëmijët pjesëmarrës u shpërndanë edhe dhuratat. Ata meritojnë më të mirat e kësaj bote, pasi janë e ardhmja jonë.
- ✦ **Korrik 2023** – Grupi Eurosig-Insig-UBA mbësh-teti nismën e violinistit me famë botërore Olen Cesari për Festivalin e Porto Palermos, i organizuar çdo fundjavë nga 15 korriku deri më 15 gusht, në kalanë e Porto Palermos. Ky festival synon të kthehet në një traditë verore, duke mbledhur çdo vit vizitorë dhe dashamirës të artit shqiptar dhe të huaj. Meqenëse kalaja e Porto Palermos ka vlera të veçanta historike, festivali synon të ringjallë këtë perlë në rivierën shqiptare. Festivali shërben jo vetëm si një festë e muzikës dhe artit, por edhe si një mënyrë për të krijuar ndërgjegjësim për çështje të rëndësishme mjedisore dhe të qëndrueshmërisë.
- ✦ **Korrik 2023** – Grupi Eurosig-Insig-UBA mbësh-teti Hemingway Jazz Fest Nr. 10, të organizuar nga Hemingway Albania. Mes qindra apasionantëve të muzikës Jazz, ky festival solli në Tiranë shumë artistë nga bota, por edhe artistë shqiptarë, të cilët krijuan



- një atmosferë mbresëlënëse. Për tre netë të paharrueshme në Korpusin e Tiranës, performuan DJ Farrapo, Eliades Ochoa, Star of Buena Vista Social Club, Funkoff, The Veeble, Newen Afrobeat, Armend Xhaferri Quartet.
- ✦ **Tetor 2023** – Eurosig dhe Generali festuan 10-vjetorin e bashkëpunimit. Në takimin e përfaqësuesve më të lartë të kompanive, në zyrat e Generali Group në Milano, u shkëmbyen eksperiencat më të mira dhe u shprehën vlerësime për këtë bashkëpunim të gjatë dhe të frytshëm. Presidenti i Grupit Eurosig-Insig-UBA, Z. Kadri Morinaj, u shpreh mirënjohjen e tij përfaqësuesve të Lartë të Generalit, duke u angazhuar për vijimin e bashkëpunimit, ku, ndër të tjera, u vu theksi te jehona e madhe turistike që Shqipëria ka marrë. Generali shprehu interes për bashkëpunime më të zgjeruara në sigurimet që lidhen me turizmin dhe më gjerë.
 - ✦ **Tetor 2023** – Menaxherë të Eurosig morën pjesë në një seminar në formë trajnimi në Kullën gjigande të Shoqërisë Generali, një ndër risiguruesit më të mëdhenj e më të vjetër në botë, prej 192 vitesh. Rreth 70 përfaqësues nga 40 vende të ndryshme nga Europa, Azia, Amerika e Jugut dhe SHBA ishin pjesë e këtij trajnimi dy ditor në Milano, të organizuar për partnerët dhe bashkëpunëtorët. Në një shoqëri që po ndryshon me hapa të shpejtë, aftësitë për të mësuar dhe për të ndjekur trajnime nga shoqëri sigurimesh si Generali janë të rëndësishme për të qëndruar konkurrues në treg dhe për të avancuar nga ana profesionale.





Konferenca Sigurimet dhe Bankat
Bashkëpunimi dhe Inovacioni janë Garanci për Klientin, duke u krijuar atyre më shumë lehtësira

- ✦ **Tetor 2023** – Grupi Eurosig-Insig-UBA zhvilloi Konferencën: Sigurimet dhe Bankat – Bashkëpunimi dhe Inovacioni janë Garanci për Klientin. Në këtë konferencë, morën pjesë drejtuesit e kompanive të Grupit dhe ekspertë të industrive të sigurimit e bankave në Shqipëri dhe Kosovë. Ndër të tjera, u diskutua për të rritur bashkëpunimin mes bankave dhe sigurimeve, duke u krijuar më shumë lehtësira klientëve tanë. Gjithashtu, u parashtruan strategji inovacioni në shërbim të industrive dhe klientit. Presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për idetë dhe strategjitë e parashtruara, duke konfirmuar mbështetje të padiskutueshme për kompanitë e Grupit. Gjithashtu, Z. Morinaj u shpreh mirënjohjen të gjithë punonjësve për punën e palodhur dhe sakrificat për të arritur rezultate kolosale. Konferenca u zhvillua në Hotelin madhështor “Belushi”, në Rugovë të Kosovës, ku Grupi Eurosig akomodoi për 3 ditë 200 pjesëmarrësit dhe organizoi një festë spektakolare me këngëtarë të njohur si Gëzim Nika, Kastriot Tusha, Josif Gjepali, Asim Gashi etj.
- ✦ **Tetor 2023** – Grupi Eurosig-Insig-UBA, në kuadër të Tetorit Rozë mbështeti simpoziumin “Luftojmë së Bashku Kancerin e Gjirit”, të organizuar nga Long Life Turkish Clinic. Qëllimi i simpoziumit ishte ndërgjegjësimi i nënave, motrave dhe të gjitha grave që të kujdesen më shumë për shëndetin e tyre, veçanërisht të kryejnë kontrole të vazhdueshme për parandalimin e kancerit të gjirit.
- ✦ **Nëntor 2023** – Në Ditën e Solidaritetit dhe Aktivizmit Social, organizuar nga rrjeti AS@N, Grupi Eurosig-Insig-UBA u krijoi mundësinë shumë të rinjve të njihen me kompanitë e Grupit, duke punuar dhe duke marrë ekspe-



riencë pranë ambienteve tona. Atyre iu akordua edhe një pagesë ditore. Ndajehemi të nderuar që iu bashkuam kësaj nisme, duke u solidarizuar me të rinjtë për të krijuar një zë të bashkuar për aktivizmin rinor.

- ✦ **Nëntor 2023** – Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Kukësit organizoi edicionin e tretë letrar “Në prehër të Gjalicës”, me shkrimtarë dhe artistë nga shumë treva të Shqipërisë e Kosovës. Për të dytin vit radhazi ky aktivitet u mbështet financiarisht nga Grupi Eurosig-Insig-UBA, me qëllim që shkrimtarët dhe artistët t’i japin më shumë vlerë këtij qyteti me tradita dhe kontribute të mëdha në shoqërinë shqiptare. Pjesëmarrësit falënderuan Presidentin e Grupit, Z. Kadri Morinaj, i cili u është gjendur gjithnjë pranë intelektualëve të Kukësit.
- ✦ **Nëntor 2023** – Presidenti i Grupit Eurosig-Insig-UBA, Z. Kadri Morinaj, mori pjesë në inaugurimin e rindërtimit të xhamisë së vjetër në “Kodër Hani” të Pukës. Z. Morinaj kontribuoi në rindërtimin e kësaj xhamie me një histori 400-vjeçare, duke i rikthyer këtij objekti fetar rëndësinë e veçantë për këtë zonë dhe historinë e saj. Më pas, Z. Morinaj, së bashku me arkitektin e njohur, Z. Artan Shkreli, dhe me Kryetarin e Bashkisë Pukë, Z. Rrok Dodaj, vizituan Shtëpinë Muze “Migjeni”. Nisur nga kushtet jo të mira të këtij muzeu, duke çmuar rëndësinë dhe vlerat e tij për identitetin tonë kombëtar, Z. Morinaj mori përsipër të

mbështesë rikonstrukcionin e muzeut, për ta transformuar në një nga destinacionet kryesore dhe më të vizitueshme në Pukë, nga turistë vendas dhe të huaj.

- ✦ **Nëntor 2023** – Në 30-vjetorin e krijimit të Fakulteti Ekonomik, të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, u organizuan disa aktivitete, që u përmbyllën me ceremoninë festive “Takim Ndër Vite”. Këto veprimtari bashkuan pedagogë, studentë, përfaqësues të pushtetit lokal e qendror, por dhe përfaqësues të Grupit Eurosig-Insig-UBA, si mbështetës i vazhdueshëm i Universitetit “Luigj Gurakuqi”. Fakulteti Ekonomik nderoi me Çertifikatë Mirënjohje Presidentin e Grupit, Z. Kadri Morinaj, i cili i përgëzoi për arritjet e deritanishme dhe konfirmoi edhe njëherë mbështetjen për Universitetin “Luigj Gurakuqi” dhe studentët e këtij universiteti, që janë e ardhmja e kombit tonë.
- ✦ **Nëntor 2023** – Kallz Multifunctional Center, me mbështetjen e Grupit Eurosig-Insig-UBA, organizoi eventin “Women Startup Competition” për idetë e grave në zhvillimin e biznesit në Shqipëri. Ky startup përzgjodhi fitueset e shpallura në Europe House, në Tiranë. Pjesë e jurisë profesionale ishte edhe Zv. Drejtoresha e Përgjithshme e Eurosig, Znj. Anila Ibro, e cila kontribuoi në përzgjedhjen e projekteve dhe ideve më të mira.
- ✦ **Dhjetor 2023** – Grupi Eurosig-Insig-UBA organizoi një festë shumë të bukur dhe shpërndau dhurata për dhjetëra fëmijë jetimë, në mesin e të cilëve ishin edhe fëmijë të punonjësve të Policisë të rënë në detyrë. Presidenti i Grupit Eurosig, Z. Kadri Morinaj, u kujdes personalisht që për këta fëmijë të shtrohej një drekë dinjitoze tek Bar Restorant “Piazza”, duke kënaqur secilin



prej tyre edhe me dhurata. Në këtë festë të fundvitit ishin të pranishëm edhe Ministri i Brendshëm, Z. Taulant Balla, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Z. Muhamet Rrumbullaku, si dhe familjarë të policëve të rënë në detyrë. Z. Morinaj falënderoi këta fëmijë që u bënë pjesë e festës dhe tregoi gatishmëri për t'i përkrahur, në momentet e tyre të vështira.

- ✦ **Dhjetor 2023** – Presidenti i Grupit Eurosig-Insig-UBA, Z. Kadri Morinaj, shtroi një drekë festive në Bar Restorant “Piazza” për fëmijët e Ushtarakëve, e cila u shoqërua edhe me dhurata për çdo fëmijë. Shoqata e Ushtarakëve të Shqipërisë i akordoi një trofe mirënjohjeje Z. Morinaj për mbështetjen e vazhdueshme.
- ✦ **Dhjetor 2023** – Grupi Eurosig-Insig-UBA mundësoi dërgimin e Teatrit Shëtitës “Çajupi” në qytetin e Krumës, në Has, me qëllim argëtimin e fëmijëve në ditët festive para ndërrimit të viteve. Teatri i kryesuar nga drejtori, z. Kiço Londo, realizoi një shfaqje shumë të bukur, e cila u ndoq nga shumë fëmijë në ambientet e Pallatit të Kulturës “Pjetër Bogdani”. Grupi Eurosig mori shumë falënderime për mbështetjen e vazhdueshme për Hasin, vendin e Pjetër Bogdanit, statuja e të cilit është lartësuar në qendër të qytetit të Krumës me mbështetjen e Presidentit të Grupit, Z. Kadri Morinaj.
- ✦ **Dhjetor 2023** – Si çdo vit, Grupi Eurosig-Insig-UBA u bë Sponsor Gjeneral i Festivalit të 62-të të Këngës në RTSH. Në këtë edicion u dhanë disa çmime, 5 prej të cilave u ndanë nga juria profesionale, ndërsa publiku zgjodhi me votim artisten Besa Kokëdhima, si këngë përfaqësuese e vendit tonë në Eurovizion.



Veprimtari të shumta në kuadër të përgjegjësisë sociale dhe promovimit të vlerave të Eurosig u zhvilluan edhe në periudhën e parë të vitit 2024, ndër të cilat, evidentojmë:



- ✦ **Janar 2024** - Grupi Eurosig-Insig-UBA mbështeti eventin në nderim të 100 vjetorit të artistit të madh "Nderi i Kombit", zotit Kadri ROSHI. Në këtë event, nëpërmjet një dokumentari, u kujtua mjeshtri i skenës dhe kinematografisë shqiptare, duke sjellë ndërmend veprën e tij artistike si monument kulture. Gjithashtu, Grupi Eurosig mbështeti edhe promovimin e librit "Në jetët e të tjerëve", ku personalitete të artit, medias dhe politikës shqiptare kanë ndarë në libër kujtimet e tyre me Kadri Roshin. Në praninë e shumë personaliteteve në këtë event, Grupi Eurosig mori falënderime të ngrohta për mbështetjen e vazhdueshme.
- ✦ **Janar 2024** - Edhe pse në ditë të ftohta të dimrit, teatri shëtitës për fëmijë vijoi shfaqjet në shumë qytete të vendit. Mbështetur nga Grupi Eurosig-Insig-UBA, ndalesat e radhës ishin në Pukë, Fushë Arrëz dhe Librazhd, ku për fëmijët u dha shfaqja "Fuqia e dëshirave". Teatri shëtitës për fëmijë do vijojë të japë shfaqje edhe në qytete të tjera.
- ✦ **Janar 2024** - Në ceremoninë e shpalljes "Qytetar Nderi" i qytetit të Durrësit të aktorit të madh Xhevdet Ferri, ishte i ftuar edhe Presidenti i Grupit Eurosig-Insig-UBA, Z. Kadri Morinaj. Në fjalimin e tij, në nderim të një prej ikonave të kinematografisë shqiptare, Z. Morinaj evidentoi se "figura

kaq të shquara, si aktori Xhevdet Ferri, kanë lënë gjurmë në memorien tonë". Grupi Eurosig-Insig-UBA mundësoi financiarisht edhe organizimin e Festivalit të Filmit në qytetin bregdetar të Durrësit. Presidenti i Grupit, Z. Morinaj, në një takim me Kryetaren e Bashkisë Durrës, Zj. Emiriana Sako, u tregua i gatshëm për të mbështetur edhe projekte të tjera në këtë qytet të mrekullueshëm.

- ✦ **Shkurt 2024** - Për Grupin Eurosig-Insig-UBA, viti 2023 ishte i mbushur me arritje dhe zhvillim të jashtëzakonshëm në fushën e sigurimeve dhe bankës. Në analizën e punës vjetore, të organizuar pranë Hotel "Marriot", u diskutuan çështjet që kanë të bëjnë me rritjen e Grupit dhe rritjen e performancës në funksion të shërbimit ndaj klientëve tanë. Regjistruam rritje të qëndrueshme në portofolin tonë, duke ofruar zgjidhje inovative dhe të personalizuar për klientët tanë të nderuar. Suksesi ynë është pasqyruar në besimin e fuqishëm të klientëve dhe përkushtimin e ekipit tonë të përzemërt. Kujdesi ynë ndaj klientit ka qenë fokusi ynë kryesor, duke plotësuar nevojat e tyre dhe duke u siguruar një jetë të qëndrueshme. Kemi përmirësuar akoma më shumë cilësinë e shërbimeve tona dhe kemi planifikuar iniciativa të reja për të ardhmen. Falënderit të gjithë klientëve tanë për mbështetjen dhe besimin e treguar; falënderim dhe mirënjohje për punën e palodhur të gjithë punonjësve të mrekullueshëm të Grupit Eurosig-Insig-UBA.



- ✦ **Mars 2024** – Si çdo vit, edhe këtë 16 Mars, Vespa Club Tirana organizoi ditën e motoçikletave ikonike Vespa. Ky event shumë i këndshëm mbledhi fansa të Vespa nga vendet e rajonit dhe më gjerë. Grupi Eurosig-Insig-UBA ju bashkua paradës me Vespa 946 Christian Dior, unike dhe e vetmja në Shqipëri. Grupi Eurosig-Insig-UBA akordoi një ndihmë finaciare për të mundësuar zhvillimin e disa eventeve në këtë ditë, të cilat nisën me parada në rrugët e Tiranës dhe u përmbyllën me një koncert nën tingujt e këngëtares Juliana Pasha.
- ✦ **Mars 2024** – Duke sjellë në skenë një komedi shumë të bukur të titulluar “Zonja e Bujtinës”, të autorit italian Carlo Goldoni, me regjinë e Sue-la Bakos dhe nën kujdesin e mësueses Orilda Kalami, nxënësit jo vetëm shijuan aventurat e personazheve dhe ngjarjeve në teatër, por zhvilluan dhe aftësitë e tyre krijuese. Grupi Eurosig-Insig-UBA, me mbështetjen e dhënë për realizimin e kësaj shfaqjeje, i frymëzoi këta të rinj të shijojnë fuqinë e artit të teatrit për të motivuar imagjinatën, miqësinë dhe guximin e tyre.
- ✦ **Mars 2024** – Klubi i basketbollit Trepça, me sponsor zyrtar Eurosig, u shpall kampion në kampionatin e Ligës Unike të zhvilluar në Vlorë. Mbështetja e Eurosig për kampionët e Kosovës do të vijojë në kompeticionet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.
- ✦ **Prill 2024** – Qindra pako me ushqime u shpërndanë në muajn e shenjtë të Ramazanit nga Grupi Eurosig-Insig-UBA dhe Alesia sh.p.k. në Kukës,



- Pukë, Has dhe Fushë Arrëz. Grupi Eurosig dhe Alesia sh.p.k. u erdhën në ndihmë me ushqime shumë familjeve në vështirësi ekonomike, duke mos bërë dallime sipas besimeve fetare, por sipas pamundësive ekonomike. Urojmë mirëqenie për të gjithë shqiptarët dhe agjërim të pranuar për besimtarët myslimanë.
- ✦ **Prill 2024** – Olen Cesari, violinist i jashtëzakonshëm me famë botërore, organizoi tre ditë koncert gjigand në Shqipëri. I shoqëruar nga International Clandestinë Orchestra, së bashku me Sergio Cammariere, Marsela Çibukaj, Carlos Paz dhe Gaz Paja, violinisti i njohur u kthye pas dy vitesh në Tiranë për t’ju dhuruar artëdashësve disa netë të paharrueshme në Pallatin e Kongreseve. Grupi Eurosig-Insig-UBA mbështeti këtë koncert me qëllim që artistët të motivohen dhe qytetarët shqiptarë të shijojnë magjinë e artit në këtë fillim vere.
- ✦ **Prill 2024** – Grupi Eurosig-Insig-UBA Bank ishte pjesë e Panairit të Karrierës me qëllim nxitjen e gatishmërisë dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve të Fakultetit Ekonomik, të Universitetit të Tiranës, një ndër fakultetet më prestigjioze në vend. Në kuadër të këtij aktiviteti u mbajt edhe një Tryezë e Rrumbullakët me përfaqësues të biznesit, të botës akademike dhe të pushtetit, ku u diskutua mbi problematikat e tregut të punës në Shqipëri. Presidenti i Grupit Eurosig, Z. Kadri Morinaj, shprehu shqetësimet lidhur me çështjet e punësimit, ku ndër të tjera u bëri thirrje të rinjve shqiptarë që të rrinë dhe të punojnë në Shqipëri, pasi ata mund ta zhvillojnë këtë vend. Interesi i studentëve për të qenë pjesë e kompanive të Grupit tonë ishte shumë i lartë. Atyre iu ofrua mundësia për t’u promovuar, intervistuar dhe vlerësuar. Shumë prej tyre aplikuan për t’u bërë pjesë e familjes tonë.
- ✦ **Prill 2024** – Grupi Eurosig-Insig mori pjesë në Panairin e Karrierës me qëllim nxitjen e gatishmërisë dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve të Universitetit Western Balkans, një ndër universitetet më prestigjioze në vend. Nisur nga interesi dhe dëshira e lartë e studentëve, atyre iu ofrua mundësia për të qenë pjesë e shoqërive Eurosig dhe Insig.
- ✦ **Maj 2024** – Pranë Akademisë së Shkencave, u zhvillua promovimi i librit “Mes jush jetoj”, një përmbledhje me krijimtarinë më të spikatur të poetit të mirënjohur Jorgo Papingji, autor i shumë teksteve të njohura të këngëve të interpretuara në Festalet Kombëtare të Këngës, për 50 vjet me radhë. Grupi Eurosig ndihmoi financiarisht për botimin e këtij libri, me qëllim që i madhi Jorgo Papingji të jetojë gjatë në kulturën dhe historinë tonë përmes veprave të tij.

Pjesëmarrjet e Eurosig sh.a. në kapitalin e shoqërive të tjera

Eurosig sh.a zotëron 100% të kapitalit të shoqërive Insig sh.a., Insig Jetë sh.a. dhe Eurosig-Invest, në Republikën e Shqipërisë, dhe Eurosig sh.a, në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit 2023, Eurosig rriti pjesëmarrjen e aksioneve pranë Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nga 65.58% në 99.46%.

Lista e aksionarëve të Eurosig në kapitalin e shoqërive të tjera



Lista e administratorëve të Eurosig

Administrator është z. Xhevdet KOPANI.

Ai nuk është pjesëmarrës në kapitalin e shoqërisë.



Njësia e Auditimit të Brendshëm në vazhdimësi, gjatë gjithë vitit 2023, ka kontrolluar dhe audituar ecurinë e punës në fushat kryesore të veprimtarisë së Eurosig

Opinion i shkurtuar mbi auditimin e brendshëm

Auditimi i brendshëm për vitin 2023 në shoqërinë e sigurimeve Eurosig sh.a. është zhvilluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", të Rregullores nr. 153, datë 23. 12. 2014, "Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit", të Rregullores nr. 7, datë 30. 01. 2015, "Për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm në Shoqërinë Eurosig sh.a." dhe të "Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 të shoqërisë Eurosig".

Njësia e Auditimit të Brendshëm në vazhdimësi, gjatë gjithë vitit 2023, ka kontrolluar dhe audituar ecurinë e punës në fushat kryesore të veprimtarisë së Eurosig. Pas shqyrtimit dhe miratimit në Komitetin e Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut, Raporti Vjetor i Auditimit të Brendshëm 2023 u shqyrtua dhe miratua edhe nga Këshilli Mbikëqyrës. Raporti u është shpërndarë për njohje dhe zbatim të gjitha strukturave të Eurosig.


Departamenti i Marrjes në Sigurim – Gjatë vitit 2023, kompania ka pasur rritje të primeve në masën rreth 10.34%. Raporti sigurime të detyrueshme/sigurime vullnetare është 80 me 20%, kundrejt objektivit të vendosur 77 me 23%. Nga analiza e këtij treguesi për vitet e fundit vihet re një trend në rënie

i tij, pavarësisht objektivit të kompanisë dhe fokusit në rritjen e shitjeve të produkteve vullnetare. Nëse analizojmë sipas njësive të shitjes, rezulton se kontributin më të madh në shitje e kanë dhënë njësitë e shitjes në Tiranë dhe Durrës. Pavarësisht performancës së mirë të disa njësive, objektivi i vendosur lidhur me produktet vullnetare nuk është realizuar pothuajse në asnjë njësi.

Ngakontrolli i komisioneve/zbritjeve rezulton se, gjatë vitit 2023, përgjithësisht është ruajtur i njëjti nivel komisionesh si në vitin e mëparshëm ose edhe ka rënë, ndërsa niveli i shitjeve është rritur. Po të analizojmë treguesin e shitjeve rezulton se rënia e komisioneve nuk ka pasur impakt negativ në nivelin e shitjeve në pothuajse asnjë njësi shitjeje të kompanisë, gjë që tregon se niveli i shpenzimeve të marrjes në sigurim duhet të monitorohet, në mënyrë që të reduktohen kostot e panevojshme të kompanisë.

Është rritur kontrolli i ushtruar nga strukturat e marrjes në sigurim në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Administrimit të Shitjeve dhe si rezultat i kësaj ka pasur një përmirësim të dukshëm lidhur me: zbatimin e procedurave të marrjes në sigurim, kushtet e kontratave të sigurimit etj. Përgjithësisht, është vlerësuar saktë risku i klientëve dhe përcaktimi i primeve është bërë në përputhje me riskun. Janë organizuar trajnime, si dhe është rritur bashkëpunimi me strukturat vendore në funksion të identifikimit të mundësive të zgjerimit të tregut.

Drejtori të tjera të kompanisë - Gjatë vitit 2023, janë krijuar Komiteti për Sigurinë Kibernetike dhe Vazhdimësinë e Biznesit, Komiteti i Risigurimit, Sektori për Sigurinë e Informacionit dhe Sektori për Investigimin & Ekspertizën. Janë rishikuar dhe përmirësuar procedurat për: trajtimin e ankesave, rezervimin e dëmeve, hartimin e dokumenteve, hartën e proceseve të dëmeve, raportimin, informimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës etj. Janë bërë përmirësime në Sistemin e Brendshëm në funksion të përshtatjes së tij me kërkesat e palëve të treta dhe strukturave të kompanisë, si dhe ofrimit të një shërbimi më të mirë për klientët. Është përmirësuar moduli i dëmeve dhe është vënë në funksion të plotë për gjenerimin e raporteve nga sistemi.



Strukturat e Trajtimit të Dëmeve kanë funksionuar mbi bazën e akteve të brendshme të kompanisë. Gjatë vitit 2023 është arritur që, sipas udhëzimeve nga Drejtoria e Përgjithshme, të trajtohen e të dëmshpërblehen klientët brenda afateve të përcaktuara. Janë trajtuar me prioritet rastet e klientëve që nuk kanë qenë dakord me dëmshpërblimet, të cilat janë diskutuar në komisionet e posaçme me qëllim që t'u shërbehet sa më mirë klientëve dhe të kryhet vlerësim sa më i drejtë. Përgjithësisht, praktikat janë plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm dhe gjatë trajtimit rezulton se janë zbatuar kushtet e kontratave të sigurimit. Është rritur numri i praktikave të zgjidhura me marrëveshje, gjë që ka ndikuar në përmirësimin e treguesit të rezervës së dëmeve në proces gjyqësor, si dhe respektimin e afateve kohore të trajtimit të praktikave.

Statistika - Të dhënat lidhur me shitjet, anulimet, kthimet, dëmtimet e policave janë të pasqyruara saktë në sistemin e brendshëm të kompanisë dhe janë raportuar saktë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Të dhënat lidhur me praktikën e dëmeve janë pasqyruar saktë në databazën e dëmeve, si dhe janë raportuar saktë në AMF. Janë respektuar afatet e dërgimit të evidencave ndërmjet strukturave, si dhe afatet e dërgimit të tyre në AMF.

Mbrojtja nga Risku - Shoqëria Eurosig sh.a., gjatë vitit 2023, ka përditësuar "Politikat dhe Procedurat për Menaxhimin e Rrezikut", në koherencë me metodologjinë re të AMF-së. Në këtë akt të brendshëm dhe në Strategjinë për Menaxhimin e Riskut janë përcaktuar sistemi, politika dhe parimet e menaxhimit të riskut. Gjithashtu, janë përcaktuar në mënyrë të plotë procesi i menaxhimit të riskut, përgjegjësitë dhe detyrat e strukturave të kompanisë për identifikimin dhe menaxhimin e risqeve. Në procesin e vlerësimit të risqeve janë përf-

shirë të gjitha strukturat e kompanisë, të cilat raportojnë në strukturën e menaxhimit të riskut çdo 3 muaj. Përfshirja e vetë strukturave në këtë proces ka pasur impakt pozitiv në identifikimin e risqeve në kohë dhe marrjen e masave për reduktimin apo eliminimin e tyre.

Drejtorja e Menaxhimit të Riskut ka hartuar “Raportin e Vetëvlerësimit të Riskut dhe Aftësisë Paguese”, në të cilin janë identifikuar dhe vlerësuar nivelet e risqeve, ndaj të cilëve është e ekspozuar shoqëria, si dhe janë dhënë rekomandimet e nevojshme për menaxhimin e tyre, me qëllim reduktimin e risqeve të identifikuara, si dhe parandalimin e ekspozimit ndaj risqeve në të ardhmen.

Në përgjithësi ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm brenda departamenteve dhe njësive të audituara, si në drejtim të hartimit të procedurave, menaxhimit të shpenzimeve dhe administrimit të dokumentacionit. Ka pasur një përmirësim të procedurave të kontrollit të ushtruar nga Departamenti i Marrjes në Sigurim lidhur me zbatueshmërinë e procedurave të marrjes në sigurim, administrimin e policave dhe, si rezultat i kësaj, problematikat janë evidentuar përgjithësisht në kohë dhe janë marrë masa për zgjidhjen e tyre. Ky sistem me procedurat dhe verifikimet përkatëse ka ndikuar në identifikimin, kontrollin dhe administrimin e risqeve që mbulojnë dhe menaxhojnë departamentet dhe njësitë e audituara.



Monitorimi, administrimi dhe kontrolli i riskut që ndërmer Eurosig

Eurosig ka implementuar një sistem të plotë për menaxhimin e riskut të shpërndarë në të gjitha nivelet, për të identifikuar, vlerësuar, mbikëqyrur, menaxhuar dhe raportuar në vijimësi risqet me të cilat është përballur ose mund të përballlet Shoqëria, sipas linjave të biznesit ose në tërësi. Strukturat e Eurosig zbatojnë elementët e këtij sistemi, duke u bazuar në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi, si dhe në natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së Shoqërisë. Për rregullimin dhe normimin e punës së strukturave të Eurosig, në drejtim të pranimit dhe menaxhimit të riskut, organet qeverisëse kanë nxjerrë një paketë aktesh të brendshme, në përputhje me përcaktimet ligjore dhe rregullatore. Gjatë vitit 2023, kemi përditësuar “Politikat dhe Procedurat për Menaxhimin e Rrezikut në Eurosig”, në koherencë me metodologjinë e re të AMF-së “Mbikëqyrja me Bazë Rrezikun”. Organet drejtuese, menaxhmenti dhe çdo punonjës ka të përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe kufizimet e autoritetit të tij, në lidhje me riskun dhe menaxhimin e tij.



Sistemi i menaxhimit të riskut në Eurosig bazohet në mirëfunksionimin e organeve qeverisëse dhe të tre linjave të mbrojtjes: funksionet Operacionale, që përfaqësojnë linjën e parë të mbrojtjes dhe kanë përgjegjësinë bazë për menaxhimin e risqeve që lidhen me fushën e tyre të përgjegjësive; funksionet e Menaxhimit të Riskut, të Aktuarit të Autorizuar dhe të Pajtueshmërisë, që përfaqësojnë linjën e dytë të mbrojtjes; funksioni i Auditimit të Brendshëm, i cili përfaqëson linjën e tretë të mbrojtjes.

Në Strategjinë për Menaxhimin e Riskut në Eurosig janë përcaktuar sistemi, politika dhe parimet e menaxhimit të riskut, procesi i menaxhimit të riskut, përgjegjësitë për menaxhimin e riskut, si dhe rrugët që do ndiqen për zbatimin e kësaj strategjie. Strukturat përgjegjëse të krijuara për të ushtruar funksionin e administrimit të riskut janë Komiteti i Auditimit&Menaxhimit të Riskut, Njësia e Auditimit, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, Komiteti për Sigurinë Kibernetike dhe Vazhdimësinë e Biznesit, Komiteti i Investimeve, Komiteti i Risigurimit dhe Komiteti i Vlerësimit të Dëmeve.

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm, komunikon me Këshillin Mbikëqyrës dhe Komitetin e Auditimit&Menaxhimit të Riskut në lidhje me vlerësimin e ekspozimeve ndaj riskut dhe masat që duhen marrë për menaxhimin e tyre, vlerësimin e ndryshimit në profilin e riskut, vlerësimin e ngjarjeve të riskut, si dhe përcaktimin e veprimeve

të përshtatshme për ndreqje të situatës.

Eurosig aplikon metodologji dhe praktika bashkëkohore për identifikimin, klasifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve, në koherencë me kërkesat e AMF-së, të përcaktuara në Manualin e Mbikëqyrjes me Bazë Rrezikun dhe akte të tjera rregullatore. Drejtoria për Menaxhimin e Riskut, në koordinim me strukturat qendrore dhe vendore, çdo vit identifikojnë risqet ndaj të cilëve është e ekspozuar veprimtaria e Eurosig dhe që përbëjnë kërcënim për realizimin e objektivave vjetore.

Procesi vjetor i Menaxhimit të Riskut në Eurosig u finalizua me:

- ✦ Raportin e Vetëvlerësimit të Rrezikut dhe Aftësisë Paguese për vitin 2023;
- ✦ Regjistrat e rreziqeve sipas rreziqeve thelbësorë dhe sipas strukturave raportuese;
- ✦ Vlerësimin e funksioneve në raport me menaxhimin e rrezikut;
- ✦ Matricën e Rreziqeve Thelbësore për vitin 2023;
- ✦ Analizën e Testeve të Paralajmërimit të Herëshëm, sipas metodologjisë së re të AMF-së; që u janë shpërndarë autoriteteve mbikëqyrëse, ekzekutive dhe menaxheriale.



Eurosig aplikon metodologji dhe praktika bashkëkohore për identifikimin, klasifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve, në koherencë me kërkesat e AMF-së

Gjithashtu, sipas përcaktimeve në aktet rregullatore, u hartua edhe Raporti "Mbi Vlerësimin e Rreziqeve në Eurosig për vitin 2023", i cili është dërguar në AMF.

Për vitin 2023, nga analiza e të gjitha rreziqeve të identifikuar, analizuar dhe vlerësuar, rezulton:

- ✦ Rreziku i Kreditit, Rreziku i Tregut, Rreziku i Dizenjimit të Produktit dhe i Vendosijes së Çmimit (i trajtuar te Rreziku i Sigurimit), Rreziku Operacional (përkatësisht Rreziku i Trajtimin të Dëmeve dhe Rreziku i Mashtrimin), Rreziku i Likuiditetit, Rreziku Ligjor dhe Rregullator, Rreziku Strategjik dhe Rreziku i Aftësisë Paguese klasifikohen në nivelin i ulët.
- ✦ Rreziku i Sigurimit (përkatësisht Rreziku i Marrjes në Sigurim dhe i Përgjegjësisive) dhe Rreziku i Teknologjisë së Informacionit (i trajtuar te Rreziku Operacional) klasifikohen në nivelin mesatar.
- ✦ Nga analiza e vlerave të Treguesve të Paralajmërimit të Hershëm, rezulton: Norma e Aftësisë Paguese është 360 pikë

përqindje (pp) mbi pragun minimal të kërkuar, Norma e Kapitalit Minimal të Kërkuar është 559 pp mbi pragun minimal të kërkuar, Marzhi i Aftësisë Paguese është 240 pp mbi pragun minimal të kërkuar, Leva Bruto dhe Leva Neto janë përkatësisht 382 pp dhe 289 pp nën pragun maksimal të kërkuar. Për rrjedhojë, Aftësia Paguese e Eurosig më 31 dhjetor 2023 dhe treguesit e tjerë kryesorë të shëndetit financiar janë brenda kërkesave rregullatore.

- ✦ Cilësia e Menaxhimit e fortë jep garanci për menaxhimin me efektivitet dhe zbutjen e rreziqeve të qenësishme të nivelit mesatar ose të lartë ndaj të cilëve ekspozohet Eurosig, çka merret në konsideratë edhe për nivelin e vlerësimit të rreziqeve të mbetur.

Autoritetet qeverisëse dhe menaxheriale të shoqërisë janë të angazhuara për ndjekjen me prioritet të çështjeve të evidentuara për secilin rrezik të qenësishëm, veçanërisht për menaxhimin me efektivitet të rreziqeve të identifikuar si kërcënim për realizimin e objektivave të shoqërisë.



Treguesit e Mjaftueshmërisë së të Likuiditetit dhe të Aktiveve në

TREGUESI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT, MË 31. 12. 2023

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
I	Kapitali bazë, Neni 76 i Ligjit 52/14 (I.a+I.b+I.c-II).	5,468,968,692
II	Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë: (II.a+II.b+II.c+II.ç).	0
III	Kapitali shtesë, neni 77 i Ligjit 52/14 (III.a+III.b+III.c+III.ç).	0
IV	Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, neni 79 i Ligjit 52/14 (IV.a+IV.b+IV.c+V).	1,280,965,466
V	Aktivitet jolikuide (V.a deri V.g).	1,270,185,466
V.h.	Elemente të tjerë të zbritshëm, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje (V.-h-1 deri V.h-10).	1,117,590,047
VI	Kapitali (Aftësia Pague).	4,188,003,226
VII	Kufiri minimal i aftësisë pague, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014.	477,936,520
XIII	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014.	370,000,000
IX	Niveli i kërkuar i aftësisë pague, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014.	716,904,780
X	Mbi (+)/nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë Pague (VI-IX).	3,471,098,446
XI	Mjaftueshmëria e kapitalit.	I mjaftueshëm

Kapitalit, Mbulim të Provigjoneve Teknike

TREGUESI I LIKUIDITETIT

Treguesi i Raportit të Likuiditetit raportohet periodikisht në AMF, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe rregullore. Shoqëria Eurosig është likuide dhe zotëron normë shumë të mirë likuiditeti pasi rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar nenit 6, pika 1, të Rregullores “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit”, rezulton më i lartë ose i barabartë me 1.

TREGUESI I AKTIVEVE NË MBULIM TË PROVIGJONEVE TEKNIKE (PT), MË 31. 12. 2023

Nr.	Emërtimi	Vlera e lejuar në mbulim të PT (në lekë)
I	Aktivitet e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14.	8,676,514,081
II	Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit.	—
III	Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, datë 28.04.2015, neni 4.	966,359,119
IV	Totali i Investimeve (I+II+III).	9,642,873,200
V	Totali i Investimeve të Lejuara (Totali i “Vlera në fakt” zbritur “Investime mbi limitet e lejuara”).	9,432,424,872
VI	Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5).	3,526,405,158
VII	Tepricë (+) /Mungesë (-) (V-VI).	5,906,019,714
VIII	Mbulimi në % (V/VI)	267.48%

Objektivat për vitin 2024

Objektivat strategjike

- 1) Rritja me 15%, krahasuar me vitin 2023, e volumit të primeve të shkruara bruto, duke garantuar rritje të kapitalit financiar, të aftësisë paguese, të performancës ekonomike, të rezervave, si dhe përsosur sistemin e kontrollit të brendshëm dhe sistemin e menaxhimit të riskut.
- 2) Në fundin e vitit 2024, raporti i volumit të primeve të shkruara bruto në sigurimin vullnetar me volumin e primeve të shkruara bruto në sigurimin e detyrueshëm të jetë 23% me 77%.
- 3) Shpenzimet për vitin 2023 të jenë jo më shumë se 95% e të ardhurave.
- 4) Vlerësim të drejtë dhe pagesë të shpejtë të dëmeve të ndodhura, si dhe rritje deri në 31% të raportit të volumit të dëmeve të paguara me volumin e primeve të shkruara bruto, deri në fund të vitit 2024.

Objektivat specifike

- 1) Nëpërmjet zhvillimit dhe drejtpeshimit të roleve të menaxhimit të performancës, të administrimit, të sipërmarrjes dhe të integritit të sigurojmë që shoqëria Eurosig të jetë efektive, efciente, proaktive dhe organike.
- 2) Zbatimi i proceseve qeverisëse të institucionalizuara, nxitja e mundësive të reja dhe menaxhimi proaktiv i ndryshimeve në tregun e sigurimeve, duke ruajtur vlerat themelore dhe avantazhin e Eurosig.
- 3) Forcimi i auditimit dhe sistemit të kontrollit të brendshëm.
- 4) Segmentimi i klientëve, duke u përqendruar tek produktet vullnetare, nëpërmjet burimeve njerëzore me formimin e duhur profesional, kombinuar me politika efektive marketingu.
- 5) Zbatimi rigoroz i politikave dhe procedurave standarde për marrjen në sigurim dhe risigurimin, me bazë riskun, duke synuar uljen e produkteve me humbje teknike.
- 6) Përmirësimi i kushteve të sigurimit të produkteve vullnetare, duke konsideruar problematikat e identifikuara në procesin e marrjes në sigurim dhe trajtimin e dëmeve.



- 7) Rishikimi i termave të marrëveshjeve të risigurimit, në lidhje me mjaftueshmërinë e mbulimit, duke reflektuar ndikimet e faktorëve të jashtëm dhe çështjet e identifikuara nga trajtimi periodik i dëmeve.
- 8) Konsolidimi i bashkëpunimit të strukturave të Trajtimit të Dëmeve me strukturat qendrore dhe vendore, përditësimi i njohurive mbi legjislacionin dhe teknologjinë bashkëkohore, me qëllim vlerësimin e drejtë dhe pagesën në kohë të dëmit.
- 9) Rritja e efektivitetit të burimeve njerëzore në fushën e intervistimit të klientëve dhe investigimit të rasteve të dyshimta, me qëllim zbulimin e rasteve të mashtrimit.
- 10) Realizimi i investimeve në fazën e dytë të Disaster Recover për Vazhdueshmërinë e Biznesit. Vijimi i investimeve në sigurinë e informacionit dhe në përmirësimin e platformave të ndërveprimit me klientët (Shërbimet Online).
- 11) Menaxhimi i kujdesshëm i shpenzimeve në tërësi, veçanërisht i shpenzimeve të përgjithshme, me objektiv rritjen e fitimit, duke siguruar një aftësi paguese të qëndrueshme, si dhe aktive të mjaftueshme në mbulim të provigjoneve teknike.
- 12) Trajnimi periodik i burimeve njerëzore, me synim konsolidimin e arritjeve dhe avancimin e mëtejshëm në përputhje me Strategjinë e Eurosig.
- 13) Pjesëmarrja në veprimtari që kontribuojnë në qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale.

Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Shoqëria EUROSIG Sh.a.

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023



Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 44 525 880
M +355 69 4014 701
www.grantthornton.al

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Aksionerët dhe Drejtimin e Shoqërisë Eurosig Sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Eurosig Sh.a. dhe shoqërive të kontrolluara prej saj ("Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2023, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat e konsoliduara financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më datën 31 dhjetor 2023, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza e Opinionit

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Çështje për t'u theksuar

Ne lidhje me komponentin e grupit, Shoqëria Eurosig Sh.a. (mëma), ne tërheqim vëmendjen në shënimin 2.4 "Bazat e Pergatitjes" të Pasqyrave Financiare të konsoliduara në të cilën paraqitet informacion mbi vendimin numër 80-2019-274 datë 01.02.2019 të marrë nga Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tirane e cila ka pranuar padinë e Shoqërisë ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për shfuqizimin e aktit administrativ, nr. 162 datë 30.07.2018 të Bordit të AMF-së dhe masat e marra sipas atij vendimi, si edhe padinë për detyrimin ndaj AMF-së për njohjen e investimit të kryer në blerjen e aksioneve në shoqëritë e kontrolluara, si aktive në mbulim të provizioneve teknike dhe aftësisë paguese. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 2254 (86-2019-2581) datë 12.07.2019, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke e kthyer atë në titull ekzekutiv, të detyrueshëm për zbatim. Për pasojë, prej 3 mujorit të dytë të vitit 2019 ka përfshirë në përlogaritjet e treguesve rregullatore investimet në shoqëritë e kontrolluara, gjë e cila ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e treguesve rregullatorë. AMF ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë për këtë vendim dhe nuk ka zhvillime të tjera lidhur me këtë çështje.

- Komponenti i grupit, Shoqëria Eurosig Sh.a. (mëma) dhe shoqëritë e kontrolluara në Shqipëri, nuk kanë zbatuar IFRS 17 "Kontratat e Sigurimit" sipas kërkesave të raportimit financiar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") për shoqëritë e sigurimit, të cilat kërkojnë zbatimin e këtij standardi për periudhën që fillon pas 1 janar 2023. Ministria e Financave dhe Ekonomisë si autoriteti me i lartë rregullator në industrinë e shoqërive të sigurimit, me ane të urdhërit nr.106, datë 10.05.2023 "Për shtyrjen e afatit të aplikimit të standardit ndërkombëtar të raportimit financiar (SNRF) 17 "kontratat e sigurimit" ka urdhëruar shpalljen e shtyrjes së afatit të aplikimit të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 17 "Kontratat e Sigurimit", me datë efektive pas datës 1 janar 2025. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.
- Komponenti i grupit, Shoqëria Eurosig Kosove Sh.a. dhe Insig Jete.Sh.a., nuk ka zbatuar IFRS 17 "Kontratat e Sigurimit" sipas kërkesave të raportimit financiar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") për shoqëritë e sigurimit, të cilat kërkojnë zbatimin e këtij standardi për periudhën që fillon pas 1 janar 2023, Banka Qendrore e Kosovës ka njoftuar se zbatimi i Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 17 (SNRF 17) për "Kontratat e Sigurimit" është shtyrë pas datës 1 janar 2026, siç është përcaktuar në publikimin e saj të datës 29 dhjetor 2023. Opinioni ynë nuk është modifikuar pe lidhje me kete ceshtje.
- Ne lidhje me komponentin Insig Jo-Jete Sh.a., ne tërheqim vëmendjen në shënimin 2.4 "Bazat e Pergatitjes" në seksionin *Parimi i vijimësisë* të pasqyrave financiare në të cilën paraqitet informacion mbi ndikimin e likuidimit të Insig Sh.a. Dega Kosove në keto pasqyra financiare pas dekonsolidimit. Humbjet e Insig Sh.a. Dega Kosove në vlerën ALL 1,332,728 mije mbarten nga ana kontabel në seksionin e kapitaleve të veta të shoqërisë meme Insig Sh.a., edhe pse nuk do të detyrojnë kompaninë të nxjerre mjete monetare në masën e kesaj humbje kontabel. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me kete ceshtje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të

bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurën auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurën të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për t-ë vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.


- marrim evidencë të mjaftueshme të auditimit të duhur në lidhje me informacionin financiar të njësisve ekonomike ose aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për kryerjen e auditimit të Grupit. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
8 korrik 2024

Kledion Kodra, FCCU



Shoqëria Eurosig Sh.a

Pasqyra e Riparaqitur e Konsoliduar e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2023

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

Shënimi	31 dhjetor 2023	Riparaqitur 31 dhjetor 2022	Riparaqitur 01 Janar 2022
Aktivi			
Mjete monetare dhe ekuivalente	8	2,935,089	3,150,201
Balanca të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	9	979,868	835,352
Depozita me afat	10	2,805,060	2,614,102
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	11	766,189	611,878
Të arkëtueshme financiare	12	11,254,590	7,861,826
Aktive të marra nga proceset gjyqësore	13	1,496	111,877
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	14	870,227	724,289
Pjesa e risiguresit në provigjionet e kontratave të sigurimit	15	818,307	895,898
Aktive ne Proces	16	1,085,345	299,848
Te arketueshme nga palet e lidhura		-	(193,293)
Aktive të tjera	17	510,036	684,239
Tatim i shtyrë	17	-	-
Aktive afat-gjata materiale	16	2,933,942	2,873,611
Te drejta te perdorimit te aseteve	18	494,095	129,673
Parapagimi i tatimit mbi fitimin	19	13,899	6,253
Investime në shoqëri të kontrolluara		-	-
Aktive te mbajtura per investim	20	273,733	473,163
Tituj kapitali	20	-	-
Fondi Garantues per BKS/Investime ne Bonde Korporative	17	30,928	28,298
Emri i mire		-	-
Aktive afat-gjata jomateriale	21	18,425	20,835
Totali i aktivitet		25,791,229	21,128,050
Detyrime			
Provigjione për kontratat e sigurimit	22	7,612,668	7,129,212
Detyrime të qirasë financiare	23	523,505	149,179
Detyrime ndaj klientëve nga aktiviteti bankar	24	8,548,186	9,900,888
Huate	25	2,560,145	151,003
-Llogari të pagueshme për sigurimin, risigurimin dhe të tjera	26	1,237,381	1,001,583
Provigjione te tjera	27	556,290	271,102
Detyrime tatimore aktuale		61,554	-
Paradhenie te marra nga depozitat	28	-	-
Tatimi i shtyre		2,287	2,319
Totali i detyrimeve		21,102,016	18,605,286
Kapitali aksioner			
Kapitali aksioner		4,515,650	2,765,650
Rezerva të tjera		10,334	10,334
Rezervë rivleresimi		948,917	954,257
(Humbje)/ Fitimi i akumuluar		(640,326)	(1,483,789)
Interesa jo-kontrollues		16,295	379,811
Rezerva e kursit te kembimit		(161,658)	(103,501)
Totali i kapitalit aksioner	29	4,689,212	2,522,763
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner		25,791,229	21,128,050

Shënimet shpjeguese nga faqa 9 deri në 71 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara. Pasqyrat financiare të konsoliduara u miratuan nga bordi drejtues i Shoqërisë më 5 korrik 2024, dhe janë firmosur në emër të tij nga:

Z. Xhevdet Kopani
Drejtor i Përgjithshëm



Znj. Anila Ibro
Drejtor i Departamentit Ekonomik
ZV - Drejtori i Përgjithshëm

Shoqëria Eurosig Sh.a

Pasqyra e Konsoliduar e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Të gjitha shumatat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	
Primet e shkruara bruto	30	6,582,163	6,032,092
Primet e ceduara në risigurim	30	(372,554)	(318,072)
Taksa mbi primet	30	-	-
Primet e shkruara neto		6,209,609	5,714,020
Ndryshimi bruto në primet e pafituara	30	(359,061)	(455,625)
Ndryshimi bruto në primet e pafituara dhe në RBNS, pjesa e risiguresit	30	32,488	21,481
Primet e fituara neto		5,883,036	5,279,876
Të ardhura nga operacionet bankare		680,699	-
Të ardhura nga operacionet bankare të tjera		36,550	-
Shpenzime për detyrim ndaj klientëve		(250,837)	-
Te ardhura nga aktiviteti bankar		466,412	-
Të ardhura te tjera	31	(202,058)	12,940
Të ardhura financiare dhe nga investimet	32	254,764	47,065
Shpenzime financiare dhe nga investimet	32	(24,662)	(6,248)
Të ardhura neto		6,377,492	5,333,633
Dëme dhe përfitime të shlyera	33	(2,153,290)	(1,877,218)
Ndryshimi në provigjionin e dëmeve	33	(227,314)	(362,071)
Dëmet dhe përfitimet e shlyera të polic-mbajtësve, neto		(2,380,604)	(2,239,289)
Zhvlerësimi i të arkëtueshme financiare, neto		-	-
Shpenzime provigjioni te aktiveve te marra nga proceset ligjore		-	-
Kosto të marrjes në sigurim	34	(1,345,120)	(1,401,625)
Shpenzime administrative	35	(1,500,053)	(1,217,678)
Shpenzime të tjera operative	36	(110,619)	(179,852)
Provigjion për humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme dhe të tjera	37	(92,553)	21,697
Te ardhura /Humbje të tjera	38	22,586	(14,466)
Humbje para tatimit		971,128	302,420
Tatimi mbi fitimin	39	(127,665)	(56,724)
Fitimi i vitit		843,463	245,696
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të vitit	16	-	108,639
Të ardhura gjithëpërfshirëse të vitit		843,463	354,335
Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		827,168	(25,476)
Interesa jo-kontrollues		16,295	379,811

Shoqëria Eurosig Sh.a

Pasqyra e Konsoliduar e Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha shumatat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	971,128	329,340
<i>Rregullime për</i>		
Amortizimi i aktiveve afatgjata	246,961	160,417
Të ardhura financiare dhe nga investimet	-	-
Fitim nga shitja/ rimarrja e Insig Jetë	-	-
Efekt i kursit të këmbimit	-	-
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(15,254)	10,536
Shpenzime interesi	-	-
Të ardhura nga interesi	51,955	40,818
Rivlerësime të aktiveve materiale	383,028	(109,563)
Shpenzimet e tatimit në prim	-	-
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues	1,637,818	431,548
Rënie në llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera të arkëtueshme	(288,916)	(911,984)
Rënie në koston e shtyrë të marrjes në sigurim (Rritje) në aktive të tjera	(145,938)	104,934
Rritje/(rënie) në provigjionet e sigurimit	(46,683)	(16,714)
Rritje/(rënie) në provigjionet e sigurimit	483,457	1,304,510
Rënie në llogaritë e pagueshme për sigurimet, risigurimet dhe llogari të tjera	297,353	492,665
(Rritje) në të arkëtueshme financiare	(3,392,764)	(7,861,826)
Rritje/(rënie) provigjione të tjera	285,188	82,399
Rritje/(rënie) në balanca të kushtëzuara me Bankën Qendrore	(190,958)	480,696
Rritje/(rënie) të detyrime ndaj klientëve nga aktiviteti bankar	(1,352,701)	9,900,888
Detyrim për Fondin e kompesimit	-	-
Rritje/ rënie e pjesës së risiguresit në provigjionet e kontratave të sigurimit	77,591	(485,588)
Interes i paguar	-	-
Mjete monetare gjeneruar nga aktivitetet operative	(2,636,553)	3,521,528
Tatimi i paguar mbi fitimin	-	-
Flukset monetare neto gjeneruar nga aktivitetet operative	(2,636,553)	3,521,528
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese		
Shtesa/pakësime të investimeve në tituj kapitali	-	455,620
Parapagime ndaj ortakut	-	-
Blerje /shitje të aktiveve afatgjata materiale	(1,852,969)	(1,033,423)
Shitje aktiveve afatgjata	15,140	-
Pakësime të aktiveve afatgjata	-	-
Rënie/(ritje) në depozitat me afat	(51,955)	(40,816)
Ndryshim në aktive të mbajtura për investim	199,430	(25,230)
Interesa të arkëtuara	-	(16,142)
Mjete monetare neto përdorur nga aktivitete investuese	(1,690,354)	(659,991)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese		
Shlyerje të qerasë financiare	374,326	109,207
Ndryshim në rezervën e rivlerësimit	-	-
Kapital i paguar	1,750,000	-
Efekte nga interesa jo-kontrolluese	(363,516)	379,811
Ndryshime në rezerva të tjera	(58,157)	(235,450)
Shlyerje për huatë e marra	2,409,142	(18,197)
Flukse monetare neto gjeneruar nga aktivitetet financuese	4,111,795	235,371
Rritja neto në mjetet monetare	(215,112)	3,096,906
Efekt i kurseve të këmbimit	-	-
Mjete monetare në fillim të vitit	3,150,201	53,295
Mjete monetare në fund të vitit	2,935,089	3,150,201

Shoqëria Eurosig Sh.a

Pasqyra e Riparaqitur e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më

31 dhjetor 2023

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

	Kapitali aksioner	Rezerva e rivlerësimit	Rezerve konvertimi	Rezerva të tjera	Fitime / (humbje) e mbartur	Interesa jo-kontrollues	Totali
Gjendja më 1 janar 2022	2,765,650	846,544	131,949	10,334	(1,568,424)	-	2,186,053
Rezervë konvertimi	-	107,713	(235,450)	-	-	-	(127,736)
Rritje e kapitalit aksionar	-	-	-	-	-	-	-
Zhbërje e RE UBA ne Konsolidim vjet	-	-	-	-	32,233	-	32,233
Interesa jo kontrollues	-	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezerves se rivleresimit	-	-	-	-	-	-	-
Fitim/ Humbja e vitit	-	-	-	-	245,695	379,811	625,506
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	2,765,650	954,257	(103,501)	10,334	(1,290,496)	379,811	2,716,056
Rregullime te viteve te meparshme	-	-	-	-	(193,293)	-	(193,293)
Gjendja më 1 janar 2022 riparaqitur	2,765,650	954,257	(103,501)	10,334	(1,483,789)	379,811	2,522,763
Rezerve konvertimi	-	-	-	-	-	-	-
Rritje e kapitalit aksionar	1,750,000	(5,341)	(58,157)	-	-	-	1,686,502
Zhbërje e RE UBA ne Konsolidim vjet	-	-	-	-	-	-	-
Interesa jo kontrollues	-	-	-	-	-	(363,516)	(363,516)
Rritje e rezerves se rivleresimit	-	-	-	-	-	-	-
Fitim/ Humbja e vitit	-	-	-	-	843,463	-	843,463
Gjendja më 31 dhjetor 2023	4,515,650	948,917	(161,658)	10,334	(640,326)	16,295	4,689,212
31 dhjetor 2022	2,765,650	954,257	(103,501)	10,334	(1,483,789)	379,811	2,522,763
31 dhjetor 2023	4,515,650	948,917	(161,658)	10,334	(640,326)	16,295	4,689,212



EUROSIG
SIGURI E STANDARDEVE EUROPIANE

 eurosig.al